



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1071 Prot.

Vlorë më, 24. 01. 2022

VENDIM

Nr. 4, datë 24.01.2022

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË SEKTORIT TË AUDITIT TË
BRENDSHËM PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 27, datë 29. 12. 2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", Ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe shkresës së Sektorit të Auditit të Brendshëm nr.74, datë 19.01.2022, në mbledhjen e datës 24.01.2022 Bordi i Administrimit,

VENDOSI



1. Miratimin e raportit vjetor të Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 74 Prot.

Vlorë, më 10 / 01 / 2022

Lënda : Miratim raporti vjetor 2021

BORDIT TE UNIVERSITETIT "ISMAIL-QEMALI" VLORE

KËTU


Në zbatim të shkresës nr. 33 prot, datë 12.01.2022 nga Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi " Raportin e veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021" po ju përcjell raportin vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Universitetin "Ismael- Qemali" Vlorë.

Bashkëlidhur raporti për miratim.

Faleminderit për bashkëpunimin !

Përgjegjës Sektori

Marjanthi Rrapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI AUDITIT TE BRENDSHEM

- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Zyra e Financës dhe Realizimit të Buxhetit, detyrimet e prapambetura (realizuar)
- Drejtoria e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë dhe Projekteve.(në proces)

Baza Ligjore

Kuadri ligjor dhe procedurial I auditimit të brëndshëm përfaqësohet nga :
Ligji Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
Ligji Nr 114/2015 ' Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik'
Manuali I Auditimit të Brëndshëm publik
Karta e Auditimit të Brëndshëm
Kuadri I Praktikave Profesionale Ndërkombëtare

Rezultatet e veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brëndshëm :

1.Lista e debitorëve në fakultete

Mbështetur në planin e punës për vitin 2021 miratuar nga Bordi Administrimit me Vendim Nr 41, datë 29.10.2020 Njësia e Auditimit të Brëndshëm realizoi angazhimin në Fakultetet e Universitetit "Ismail-Qemali" për verifikimin e listave të debitorëve.

Në planin e vitit 2020 sektori auditit realizoi auditimin në Fakultetin e Shkencave Humane për listat e debitorëve me kërkesë nga Bordi Administrimit, si problematikë e ngritur nga Administratorja e mëparshme.Gjate këtij auditimi , grupi auditues kontrollloi kampione të transaksioneve për të parë nëse kontrollet funksionojnë sipas projektimit.U konstatua paqartësi nga ana jonë ,se pagesat apo mospagesat e tarifave shkollore të studentëve janë të rregjistruara në mënyrë të saktë (mospatja e detajeve të transaksioneve),apo se këto transaksione janë rregjistruar në periudhën e duhur dhe verifikuar nga të treja zyrat e përfshira në auditim.Për këtë arsye grupi auditit nuk dha dot siguri të arsyeshme mbi saktësinë e numrit të studentëve debitorë apo vlerën financiare.Nga kjo problematikë e konstatuar në Fakultetin e Shkencave Humane, në planin e vitit 2021 Sektori Auditit të Brëndshëm planifikoi një angazhim auditimi në të gjitha fakultetet për këtë problematikë.

Programi angazhimit u firmos në datë 04.02.2021 me nr 220 prot, me objekt auditimi përputhshmëri dhe financiar. Metoda e e auditimit ishte ajo e inspektimit fizik dhe leximit të raporteve. Afati auditimit ishte 17.02.2021 deri në 20.04.2021. Auditimi u krye nga grupi i Auditimit me përbërje:

- Marjanthi Rrapaj (Përgjësë)
- Ermonela Spahiu
- Dorina Ilnica



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI AUDITIT TE BRENDSHEM

2017-2019. Për arsye të sipërpërmundura grupi auditit e kreu angazhimin e auditit vetëm me objekt përputhshmërie. Nga auditimi I kryer në fakultete, grupi auditit ka kryer një punë voluminoze për evidentimin e pagesave ndër vite të studentëve. Database I dorëzuar prej grupit të auditit në raportin final pasqyron një plotësim të pagesave (me data, bankën ku është kryer pagesa dhe

kësteve të paguara) e një numri të madh studentësh në degë të ndryshme, duke kryqëzuar të dhënat e thesarit (ku regjistrohen pagesat e kryera në bankë) me database e zyrave të shërbimit të studentit.

Në fakultetin Ekonomik u verifikuan 7625 studente bachelor dhe master në vite të ndryshme studimi. Për të gjithë është krijuar database me pagesa, në shumicën e rasteve të gjitha këstet.

Në fakultetin e Shkencave Teknike u verifikuan 82 studentë në bachelor dhe master.


Në fakultetin e Shëndetësisë u verifikuan 135 studentë në bachelor dhe master.

Në fakultetin e Shkencave Humane u verifikuan 553 studentë në bachelor dhe master.

Gjithsej grupi auditit plotësoi një database me pagesat e 1400 studentëve për vitet 2017-2019 (pjesën më të madhe me me shumë se pagesën e një kesti) duke bërë të mundur gjurmimin e studentit ndër vite.

Për të përmirësuar situatën dhe funksionimin e një sistemi të brëndshëm kontrolli u lanë rekomandimet si më poshtë :

Nr.	Rekomandimet	Niveli i Riskut
1	Të merren masa për plotësimin e plotë të pagesave të studentëve nga të ardhurat e thesarit për vitet 2017-2020.	I LARTE
2	Zyrave përkatëse tu ngarkohen detyra konkrete në funksion të mbledhjes së të ardhurave	I LARTE
3	Pagesa e studentit të hidhet me data, të citohet banka dhe të mbahen faturat e çdo studentit për verifikim të pagesës së plotë të tarifës së shkollës deri në përfundim të ciklit të studimeve. (deri në momentin e diplomimit)	I MESEM
4	Lista e debitorëve që nxjerr shërbimi ndaj studentit të përcillet sektorit të financës dhe buxhetit dy herë në vit pas mbarimit të sezonit të provimeve.	I MESEM
5	Të përcillet modeli tabelës (dërguar nga dshm) i pagesave të studentëve që do të plotësohet nga zyrat e shërbimit studentor	I ULET



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI AUDITIT TE BRENDSHEM

	kronologjik dhe pa gabime.	
4	Për çdo procedurë prokurimi, në përfundim të saj, të printohet raporti përmbljedhës i gjeneruar nga SPE.	I ulet
5	Dosjet të jenë sipas VKM 914 datë 29.12.2014 (i ndryshuar)	I ulet

3. Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore

Mbështetur në planin e punës për vitin 2021 miratuar nga Bordi Administrimit, Njësia e auditit të brendshëm realizoi angazhimin në Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Ky Raport Auditimi përmbljedh punën e bërë nga grupi i auditimit në teren në lidhje me rregullshmërinë ligjore, vlerësimin e veprimtarisë së sektorit nëse është në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore, vlerësimin e efektivitetit të vlerësimit të brendshëm. Auditimi u realizua për vitet 2019 dhe 2020, me metodën e testimit të detajuar. Dosjet u përzgjidhën në mënyrë rastësore në të gjithë sektorët që u kontrolluan. U konstatua se Drejtoria ka punuar në përputhje me ligjet, vkm-të dhe aktet nënligjore në fuqi. Pas mbarimit të angazhimit u lanë rekomandimet si me poshtë:

Nr.	Rekomandimet	Niveli riskut
1	Me qëllim mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional në funksion të forcimit dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme. Drejtoria në bashkëpunimin me strukturat përkatëse të marrë masat për zbatimin e planifikimit të nevojave të stafit me qëllim hartimin dhe ndjekjen e planit të trajnimit të personelit administrativ.	I mesëm
2	Të miratohet sa më shpejtë rregullorja e sektorit II.	I mesëm

Pas dorëzimit të projekt raportit në datë 07.12.2021 me nr 1882 prot,u zhvillua një takim përmbyllës me Drejtuesen e Drejtorisë . U ra dakord për rekomandimet e lëna dhe nuk kishte asnjë objeksion nga Drejtoria e Audituar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI AUDITIT TE BRËNDSHEM

detyrime që janë ende pa likujtuar, brenda datës 28.02.2022. Njësia e Auditit të Brendshëm, pas këtij afati do të rikthehet për të vlerësuar situatën.

5. Drejoria e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë dhe Projekteve

Angazhimi në Drejtorinë e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë dhe Projekteve është në proces realizimi.

*Monitorimi sistemit dhe sigurimit të cilësisë

Për të rritur cilësinë e auditimeve është kryer në vazhdimësi rishikim I punës së audituesve. Në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe zbatimit të standarteve të auditimit ka vënd për përmirësim. Gjatë planifikimit të grupit të punës që mer pjesë në një mision auditimi, është vlerësuar performanca, përvoja dhe kualifikimi e gjithësecilit. I gjithë procesi auditimit është mbikëqyrur rregullisht duke respektuar programin e auditimit dhe trajtimit të problemeve që mund të lindin gjatë një program auditimi.

*Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve.

Në objektivat e planit të punës është edhe ngritja profesionale e audituesve në Njësinë e Auditit të Brendshëm. Për vitin 2021 u ndoqen trajnimet e organizuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brëndshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Përgjegjëse Sektori

Marjaunthi Rrapaj